



Deklaratë Përmbyllëse e vizitës së stafit

Tiranë, 27 Shtator 2013

Dobësitë ekonomike dhe çekuilibrat makroekonomikë të shtuar përbëjnë sfida domethënëse për politikën. Në radhë të parë, borxhi publik ka arritur një nivel të panjohur më parë për Shqipërinë, pjesërisht për shkak të akumulimit të faturave të papaguara dhe detyrimeve të prapambetura të qeverisë. Kthimi në rrugën e qëndrueshmërisë së borxhit do të kërkonte një angazhim të fortë për një konsolidim fiskal të qëndrueshëm në afatin e mesëm, duke filluar nga buxheti i vitit 2014, i mbështetur në politika konkrete dhe reforma strukturore që adresojnë rrënjën e problemit të defiçiteve të larta. Megjithatë, pozicioni i dobët i ciklit ekonomik vendos një limit të sipërm në madhësinë e korrektimit të menjëhershëm që Shqipëria mund të ndërmarrë pa patur pasoja negative ekonomike dhe sociale. Ringjallja e kreditimit do të varet nga shlyerja e detyrimeve të prapambetura dhe e faturave të papaguara dhe pastrimi i bilanceve të bankave dhe firmave private.

1. **Ekonomia është e dobët për shkak të kërkesës së dobët vendase.** Rritja pritët të mbetet e ulët në vitin 2013, në 1.7 përqind pasi stanjacioni në kreditim, bilancet e dobëta të korporatave dhe rënia e dërgesave të emigrantëve e kanë dobësuar kërkesën e brendshme, ndërsa rritja e detyrimeve të prapambetura e ka përkeqësuar situatën e likuiditetit në sektorin privat. Ulja e ndjeshme e importeve dhe përmirësimi atipik i bilancit tregtar të energjisë për shkak të prodhimit të lartë të hidrocentraleve dhe eksporteve—kanë çuar në një korrektim të moderuar të llogarisë korrente. Ekonomia mund të rritet në mënyrë modeste në vitin 2014, në rast se autoritet do të fillojnë politikën aq të nevojshme dhe reformat strukturore. Me prodhimin nën potencial dhe papunësinë mbi trend në vitet 2013-14, misioni pret që inflacioni të mbetet i ulët.

2. **Çekuilibrat e brendshëm janë përkeqësuar ndjeshëm.** Devijimet fiskale në pjesën e parë të vitit 2013 – që rrjedhin kryesisht nga performanca e dobët e të ardhurave tatimore, së bashku me akumulimin e një stoku të madh faturash të papaguara dhe detyrimesh të prapambetura (kryesisht në dy vitet e fundit) pritët që ta çojnë borxhin publik në 70% të PBB-së në fund të vitit 2013, krahasuar më 59% në vitin 2010. Buxheti ka një nevojë të lartë për financim—përfshirë këtu për shkak të strukturës së maturitetit afatshkurtër të borxhit të brendshëm. Interesat e bonove të thesarit kanë rënë në vitin 2013 pavarësisht përkeqësimit të financave publike, çka pasqyron lehtësimin e politikës monetare, inflacionin e ulët dhe ngurrimin ndaj riskut të bankave, që kanë preferuar të blejnë letrat me vlerë të qeverisë përpara kreditimit të sektorit privat. Kreditë nën standart kanë vazhduar të rriten në gati 24 përqind të totalit të kredive, ndërsa sektori bankar mbetet i cënueshëm nga goditjet që vijnë nga mëmat e tyre jashtë, përfshirë këtu dhe ndryshime të kuadrit rregullator.

3. **Mosveprimi do të përbënte një rrezik të madh për stabilitetin ekonomik.** Pa politikat e nevojshme dhe reformat strukturore, borxhi publik do të vazhdonte në trendin e vet rritës dhe do të ndikonte negativisht në rritjen ekonomike, veçanërisht nëse normat e interesit rriten dhe fillojnë të kufizojnë hapësirën për investime private në afatin e mesëm. Përkeqësimi i perceptimit të riskut sovran në tregun e brendshëm të bonove mund të ndikojë në oreksin dhe gatishmërinë për të financuar borxhin e qeverisë, çka mund të rezultojë në rritjen e interesave dhe mbase në një korrektim fiskal të detyruar.

Ulja e rreziqeve për qëndrueshmërinë fiskale dhe të borxhit

4. **Për të ulur dobësitë që shoqërohen me borxhin e lartë dhe për të rindërtuar amortizatorë fiskalë kundër goditjeve, autoritetet duhet të angazhohen për një objektiv të besueshëm afat-mesëm për borxhin.** Për të ankoruar pritshmëritë, misioni rekomandon që autoritetet të angazhohen për një objektiv dhjetëvjeçar ambicioz, por të arritshëm për të ulur borxhin në 40 përqind të PBB-së, si dhe për një objektiv të ndërmjetëm që synon që borxhi të shkojë afër nivelit 60% të PBB-së në pesë vjet. Arritja e objektivit të ndërmjetëm do të kërkojë konsolidim fiskal të qëndrueshëm në afatin e mesëm. Misioni i rekomandon autoriteteve që të angazhohen për të arritur një ulje në raportin e borxhit me PBB-në në vitin 2015, si një hap i parë i besueshëm drejt një përpjekjeje afatmesme për korrektim.

5. **Buxheti i vitit 2014 duhet të fillojë procesin e konsolidimit fiskal duke marrë parasysh njëkohësisht ekonominë e dobët.** Përmbysja e trendit të rritjes së borxhit publik në vitin 2014, apo dhe mbajtja e borxhit në të njëjtin nivel në raport me PBB-në sa në vitin 2013, do të kërkonte një korrektim fiskal tepër të madh. Duke qenë se prodhimi pritet të mbetet nën potencial në vitin 2014, masa e korrektimit fiskal duhet të kalibrohet për të shmangur pasojat negative në rritjen ekonomike dhe situatën sociale. Megjithatë një korrektim fiskal në masën 1½ të PBB-së do të ishte i nevojshëm për të sinjalizuar seriozitetin e autoriteteve në arritjen e qëndrueshmërisë së borxhit.

6. **Buxheti i vitit 2014 duhet të mbështetet në masa specifike dhe konkrete.** Nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse ndaj reformës tatimore dhe misioni diskutoi opsionet e mundshme, përfshirë këtu planet e autoriteteve për të prezantuar një taksë progresive për të ardhurat personale, ndryshime në tatimin e fitimit dhe akcizës. Për të përmirësuar administrimin tatimor janë të nevojshme veprime të vendosura, ndonëse këto masa me gjasë do t'i japin përfitimet vetëm në afatin e mesëm. Misioni rekomandon që masat ndihmëse për shtresat në nevojë duhet të kenë formën e mbështetjes buxhetore direkte dhe të targetuar dhe jo atë të lehtësirave tatimore që shtrembërojnë sistemin e të ardhurave dhe nuk sjellin domosdoshmërisht përfitime për të varfërit. FMN-ja është e gatshme për të ofruar asistencë teknike të mëtejshme.

7. **Për të siguruar besueshmëri, autoritetet duhet të shpallin synimin e tyre për të zbatuar reforma fiskale ambicioze në afatin e mesëm.** Misioni i sheh reformat në sistemin e sigurimeve shoqërore dhe ato të sektorit të energjisë si thelbësore. Sistemi i pensioneve është aktualisht në defiçit dhe me plakjen e parashikuar të popullsisë në dekadat e ardhshme, nuk do të jetë në gjendje të përballojë kërkesat në rritje për pensione. Misioni i inkurajon autoritetet të hartojnë një plan reformash që parashikon ndërmjet të tjerash dhe përfshirjen në skemë të punëtorëve të sektorit bujqësor, heqjen e shtysave negative për njerëzit me të ardhura të larta për të marrë pjesë në skemë dhe rritjen e moshës së pensionit. Në mënyrë të ngjashme, reforma në sektorin e energjisë është kritike për qëndrueshmërinë e sektorit dhe për të siguruar që ai nuk do të vazhdojë të përbëjë një

rrezik fiskal. Reformat fiskale, përfshirë këtu ato të lidhura me të ardhurat dhe menaxhimin e financave publike do të jenë kyçe.

8. Adresimi i problemit të faturave të papaguara dhe detyrimeve të prapambetura do të rriste besueshmërinë e qeverisë dhe do të përmirësonte likuiditetin dhe besimin. Pastrimi i këtyre detyrimeve do të forconte bilancet e sektorit privat, do të lehtësonte rinisjen e rritjes së kreditimit duke ndihmuar në uljen e kredive nën-standart dhe duke mbështetur kërkesën vendase. Ndërsa niveli i saktë i faturave të papaguara dhe detyrimeve të prapambetura të qeverisë qendrore nuk mund të bëhet i ditur pa ndërmarrë një ushtrim gjithpërfshirës, vlerësimi paraprak i misionit sygjeron se ato mund të jenë rreth 4 përqind të PBB-së. Misioni sygjeron një qasje të trefishtë për të adresuar problemin: i) të nxitet sektori privat për të paraqitur pretendimet e tij brenda një afati kohor të arsyeshëm; të verifikohet masa e vërtetë e këtyre detyrimeve pas një auditimi të kujdesshëm (preferohet një palë e jashtme) dhe përfshirja e tyre në statistikën e borxhit publik; ii) shpallja e një afati për të shlyer këto detyrime dhe fillimi i zbatimit; si dhe iii) ndërmarrja simultane e reformave në menaxhimin e financave publike për të parandaluar një rishfaqje të problemit.

Lehtësimi i pastrimit të bilanceve për të nxitur rritjen e kreditimit

9. Një rritje e shpejtë në kreditim është e kushtëzuar nga progresi në ristrukturimin e bilanceve të rënduara të firmave private. Niveli i lartë i kredive nën standart dhe gjendja e vështirë e bilanceve të kompanive private shpjegojnë pjesërisht ngurrimin e bankave për të ndërmarrë rrezikun e lartë të kreditimit. Kreditimi do të vazhdojë të mbetet i dobët, derisa të ketë përmirësime në këtë front. Misioni i mirëpret përpjekjet e bëra së fundmi nga autoritetet për të parandaluar vonesat në proceset gjyqësore dhe për lehtësimin e ekzekutimit të kolateralit, por i inkurajon ato për të vazhduar dhe me masa të tjera që mbështesin pastrimin e bilanceve të bankave, përfshirë këtu ristrukturimin e kredive dhe heqjen e shtrembërimeve tatimore, si dhe lehtësimin e marrëveshjeve jashtë gjykatave.

Vigjilenca e vazhdueshme nga ana e mbikqyrjes është thelbësore duke patur parasysh nivelin e lartë të kredive nën standart dhe normën e ulët të fitimit. Monitorimi strikt i kredive nën standart, zbatimi i provigjionimit të huave dhe garancia që bankat do të përgjigjen menjëherë për të plotësuar rëniat në kapital, janë thelbësore. Misioni mirëpriti synimin e autoriteteve për t'u bërë pjesë e Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP).

Misioni i falenderon autoritetet dhe homologët e tjerë për diskutimet e hapura dhe konstruktive.